




Rruga e Islamit **RRUGA E DITURISË**



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit
Nr. 09 (472)
Shtator, 2022

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Rruga e Islamit, rruga e diturisë / Redaksia

6 Myslimani i vërtetë rezaton paqe dhe siguri / Mehmet Disha

8 Lajme / Aktivitete



12 Islami nuk është rëndësë për askënd / Agim Baçi

14 Sahabja e nderuar Durretu bint Ebi Leheb (r.a.) / Eduart Demiraj

16 Lidhja mes Resulullahut dhe Umetit të tij / Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1", botim i KMSH

20 Kur fillova ta dua veten / Charlie Chaplin

22 Pse duhet të jemi shembulli i një morali të bukur? / Asim Shark

24 Sikur e vërteta është për dikë tjetër, e jo për ne / Nga hutbet e Profetit Muhamed (a.s.)



26 Qytetnim'i çalë / Retrospektivë

28 Daut Boriçi, dijetari i shquar islam / Personalitet

32 Ndiheni të uritur emocionalisht? / Aisa Kokiçi

34 Mjalti, antibiotiku natyral / Fethi Yaman

38 Ku është ai? / Arjola Zaçi





Rruga e Islamit

RRUGA E DITURISË

Në historinë e zhvillimit të Islamit, vend shumë të rëndësishëm zë edukimi me dituri e drejtësi. Një nga qëllimet e fesë islame është popullarizimi i edukimit të gjithanshëm të njeriut, sepse kjo veprimtari ka qenë dhe është një nga themelet bazë të kulturës e të qytetërimit islam. Ajeti i parë që iu shpall Pejgamberit a.s. deklaroi: "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej gjaku të ngjizur. Lexo, se Zoti yt është më Bujari. Ai që e mësoi njeriun të shkruajë me penë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte". (96: 1-5)

Konsolidimi, shtimi, sistemimi dhe ruajtja e dijeve në fushën e diturisë është detyrë primare e dijetarëve dhe e besimtarëve myslimanë, për t'i mësuar gjeneratës së tashme dhe atyre që do të vijnë se ajetet e Kur'anit përmbajnë material të mjaftueshëm me karakter shpirtëror e shkencor, që i nxit myslimanët të studiojnë gjithçka; se Islami ka qenë fatktor përcaktues në qytetërimin dhe Rilindjen Evropiane; se Islami është fe e zhvillimit, e paqes, e begatisë, dhe se ai është sistemi i demokracisë e barazisë kundër çdo lloj diskriminimi nacional, racor apo klasor.

Shembullin më të mirë se si u tubua dhe u ruajt dija islame e jep Kur'ani i Shenjtë, i cili iu shpall Pejgamberit a.s. Ai bëri përpjekje të mëdha për ta ruajtur të qartë, ashtu siç iu shpall, duke e mësuar përmendësh. Miqve të vet besnikë dhe të kujdesshëm ua diktoi ngadalë, që edhe ata ta mësonin përmendësh e ta shkruanin. Kur Pejgamberi a.s. ndërroi jetë, pasuesit e tij besnikë, për ta ruajtur Kur'anin famëmadh, e mblodhën dhe e shkruan në disa kopje unike prej burimesh të sigurta. Ajo mbledhje u përhap nëpër gjithë territoret islame të asaj kohe dhe është në përdorim pa asnjë ndryshim edhe sot.

Kur'ani është i mrekullueshëm, sepse shumë dukuri e ligje të natyrës dhe të njerëzimit janë përmendur aty shumë kohë më parë se njeriu t'i zbulonte dhe t'i vinte në jetë. Libri i shenjtë zbriti që të nxisë mendjet njerëzore t'i mësojnë dhe t'i zbatojnë ato. Dihet se zbulimet e reja janë rezultat i hulumtimit dhe zhvillimit mendor. Ato s'janë zbulime të rastit, sepse iu kanë paraprirë zbulime dhe hulumtime të parashikuara. Në suren "Fussilet", ajeti 53, thuhet: "Ne do t'u bëjmë atyre të mundur që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në vetet e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?!"

Mrekullia e Kur'anit hyn thellë në zemrat e lexuesve të tij, shpirtrat e tyre i rrëmben dhe i bën për vete në mënyrë të jashtëzakonshme. Kur'ani u mëson njerëzve të adhurojnë vetëm një Zot, i fton të heqin dorë nga mëkatet dhe krimet.

Përhapja me shpejtësi e Islamit dhe e kulturës së tij i kushtohet tërësisht besimit dhe respektimit të parimeve të tij dhe s'kishte forcë që t'ia ndalte hovin. Dijetarët, të cilët në veprat e tyre përshkruan Spanjën, Portugalinë, Francën, etj., thonë se popullsia vendase i priti myslimanët si çlirimtarë. Ky depërtim nuk kish të bënte aspak me ekspedita pushtuese, përkundrazi, ishte depërtimi i qytetërimit të ri. Lion Fojhtvanger, shkrimtar gjerman me prejardhje hebreje, në librin e tij "Balada spanjolle", thotë: "Zotërinjtë e rinj sollën me vete kulturë të lartë dhe Spanjën e shndërruan në vendin më të bukur të Evropës".

Myslimanët zhvilluan në mënyrë të mahnitshme urbanistikën dhe arkitekturën dhe si rezultat lindën qytete të mrekullueshme, që nuk ishin parë që nga koha e qytetërimit romak. Si shembull përmendim Kordobën, që asokohe ishte kryeqytet i botës perëndimore.

Qytetërimi dhe kultura e re, e futur dhe e zbatuar me urtësi në fushën e edukimit të përgjithshëm, pa dallim klasash shoqërore, çoi në përparimin e popujve në të gjitha drejtimet. Myslimanët ripërtërinë bujqësinë, industrinë minerare, artizanatin, letërsinë, artet e bukura, etj. Ata bënë një tregti të shumëllojtë, duke përshkruar të gjitha territoret islame, me rrugë tokësore e detare. Lundërtarët myslimanë spanjollë lundronin të lirë, shpejt e me siguri në shumë dete, me anijet më moderne të kohës. Çdo qytet i madh kishte universitetin e tij dhe

biblioteka shumë të pasura. Arti dhe shkenca lulëzuan si asnjëherë e, sipas dëshmimeve, qyteti i Kordobës kishte mbi 3000 shkolla.

Vlen të përmenden se Evropa Perëndimore në mesjetë ka qenë në errësirë të plotë, kurse pjesa e saj e udhëhequr nga myslimanët nuk mund të quhej e tillë. Ajo pati zhvillim dhe përparim të shkëlqyer. Arritjet në fushat ideore, kulturore, artistike e materiale, pa më të voglin dyshim ushtruan një ndikim të madh në Rilindjen Evropiane.

Në shumë vende Kur'ani i shenjtë i lavdëron dijetarët, si për shembull: "Allahu do t'i lartësojë në pozita ata që besojnë dhe ata që iu është dhënë dituria". Edukimi arsimor është i lavdëruar në Islam e për myslimanët është gjëja më e lartë në jetë. Ata që merren me këtë edukim porositin të shkruajnë, të përhapin, të lartësojnë dhe të zhdukin analfabetizmin kudo. Përhapja e diturisë, nëpërmjet edukimit, ka qenë në nivel mjaft të lartë gjatë periudhës së zhvillimit të Islamit.

Islami kërkon që çdo besimtar të kërkojë diturinë, ta zbatojë atë dhe të përpiket për përhapjen e saj. Për të gjitha këto kemi shumë hadithe, tek të cilët duket qartë vlerësimi dhe lartësimi që iu bëhet dijetarëve, që hulumtojnë dhe përhapin diturinë. Zbatimi në praktikë i edukimit islam, ka për qëllim pastrimin shpirtëror nga prapësitë morale të botës, si zilia, mashtrimi, arroganca, mendjemadhësia, mburrja, hipokrizia, etj., dhe mbushjen e saj me moral të lartë si ditori, traditë e mirë, mirënjohje, sinqeritet, devotshmëri, pendim, etj.

Shkollimi dhe edukimi i vajzave dhe i djemve në Islam bëhet pa dallim dhe është i detyrueshëm. Fëmijëve nuk u lejohet punësimi pa përfunduar edukimi. Në lëmejtë e diturisë dhe të edukimit dijetari mund të arrijë në shkallët më të larta të piramidës, pavarësisht nga gjendja shoqërore ose ekonomike. Kjo tregon se Islami është fe e demokracisë së vërtetë, e barazisë dhe e së drejtës absolute. Dijetari jeton kudo prej diturisë së tij dhe kurrë nuk konsiderohet i huaj.

Në periudhën e lulëzimit të Islamit, dijetarët jomyslimanë jo vetëm nuk u persekutuan, por, përkundrazi, të ndihmuar nga ata myslimanë, përkthyen Ungjillin në gjuhën arabe. Hebrejtë zhvilluan lirshëm prozën dhe poezinë e tyre, përsosën sistemet filozofike, përkthyen Aristotelin dhe veprat e tij i shtrinë në filozofinë e librit të tyre të madh.

Edukimi me diturinë në Islam është një prej të drejtave themelore të njeriut, po aq i rëndësishëm sa ajri, uji dhe ushqimi.

Këto janë pikëpamjet e Islamit në mënyrë përmblendhëse për sa i përket diturisë, në të cilën akumulohen të gjitha njohuritë e dobishme që i nevojiten njerëzimit e që myslimanët i ruajtën dhe i përhapën në mënyrë të përkryer në popuj të tjerë. Pra, është në nderin dhe dinjitetin e të gjithë myslimanëve, duke përfshirë edhe ata të Shqipërisë, që të përvetësojnë dhe përhapin diturinë islame.



Myslimani i vërtetë
RREZATON PAQE DHE SIGURI

Vërtet lajmet në përditshmëri nxjerrin vetëm të këqijat e njerëzve, por kjo ka qenë përherë: një pakicë trazon qetësinë e të gjithëve, me një veprim të gabuar, mirëpo ka dhe gjëra të mira e të bukura që ndodhin atje jashtë me shumicë, ka njerëz që promovojnë mirësi dhe rrezatojnë shpresë e besim, njerëz që merren vesh dhe që nuk të gjen e keqja prej dorës a gjuhës së tyre, thjesht nuk i nxjerr kush në lajme.

Na duhet të ndërgjegjësojmë gazetarët dhe qasjet e tyre sa më shpejt, sepse nuk është media dhe gazetaria veç për lajme ndodhish ku, për shkak se tërheq sy e bën bujë, lajmi negativ mbizotëron mbi lajmet e tjera pozitive dhe gjërash që ndodhin. Këtyre u shtohet edhe pjesa e atyre që shkruajnë mendimet në këtë platformë a në rrjete sociale të tjera. Krejt japin mend dhe krejt shohin zyrtë.

Ç'vlerë ka të konstatosh një zyrtësi e të bësh tellallin duke i dhënë jehonë ndër njerëz të tjerë, ku s'ke potencialin intelektual dhe shpirtëror për të ruajtur balancat dhe për të ofruar së paku një zgjidhje?!

Është fakt që qeveria jonë dhe të gjitha qeveritë e deritanishme kanë lënë varfëri e pakësim kushtesh te njerëzit, si edhe është fakt që njeriu i kohës është kafshëruar si pasojë e rrymave dhe e filozofive që nuk dinë se ç'thonë për njeriun dhe për ekzistencën e tij, por nga ana tjetër, të postosh lajme pozitive dhe të ruash balancën e dozës së llojit të informacionit që përçohet te lexuesit, duke mos ngulmuar te lajmet e zeza, nuk do të thotë se po mbulon faktet për të përkhrahur qeverinë. Aspak. Thjesht, njeriu duhet të kërkojë zgjidhje, duke mos i zmadhuar fatkeqësitë, por duke i sheshuar me lutje dhe duke i përpjekur për të ofruar mundësi aë njerëzit të mund të ruhen, të ndërgjegjësohen, të kthjellohen.

Në lidhje me zemërimin, profeti Muhamed a.s. ofronte zgjidhje, duke qartësuar dëmet që zemërimi ka te njeriu dhe te bota përreth, duke i thirrur ndërgjegjes njerëzore, pastaj u thoshte ndjekësve të tij: "kur të jesh i zemëruar, ulu, ose shtrihu derisa të të kalojë". Është gjendje që të gjithë e kanë si potencial, por nuk është domosdoshmëri të përdoret, thjesht duhet menaxhuar. shejtani e shfrytëzon këtë rast. Nëse nuk kalon, shkon e merr abdest, pastrohesh me

ujë, qetëson gjymtyrët duke i larë, kryet duke e fërkuar me dorën e lagur, e më pas fal namaz, del përpara Krijuesit dhe kërkon mbrojtjen e Tij nga mendimet e këqija të vetes e të djajve që shkaktojnë ngatërresa ndër njerëz.

Këtu, profeti Muhamed a.s. bën edhe një dallim madhor duke cituar se: "Nuk është i fuqishëm ai që ka fuqi trupore, i fuqishëm është ai që frenon veten kur zemërohet." Dhe detyra e të gjithëve, por sidomos e besimtarëve që u besojnë fjalëve të të Dërguarit, është të bëjnë përherë kujdes duke qenë në vigjilencë, duke mos e lënë zemrën në përhumbje, e përhumbja të çon në gabime madhore.

Sigurisht praktikat fetare, edukimi fetar, zgjerimi i dimensioneve të njohjes dhe të qenit i lidhur me Zotin për të fituar kënaqësinë e Tij, është misioni kryesor i Islamit që synon te individ. Kjo gjë, pra po të ndodhë që njeriu ta forcojë veten në këtë rrugë, ai bëhet promovues i paqes dhe rrezaton dritë përreth!

Por ndodh që njeriu harron e bën gabime për të cilat nuk pendohet dhe ngadalë merr rrugën e së keqes. Zot ruana! Nevojitet vazhdimisht të qartësojmë veten se duhet të kënaqim Zotin dhe vetëm Atë! Larg Tij, çdo gjë është barrë dhe çdo gjë është lodhje për zemrën.

Bota është krijuar si sprovë dhe duke qenë se është e përkohshme, nuk vlen të lidhësh zemrën me të. Kjo nuk është kaq e lehtë. Praktika është ajo që e forcon bindjen dhe besimi lind pas përpjekjes. Namazi, leximi i Kur'anit, agjërimi, dhënia e zekatit, duatë dhe lutjet, namazi i xhumasë dhe hutbet, duhet që të zgjojnë te njeriu dhe te zemra e tij besimin në Zot dhe mirësitë e moralit dhe frytet e karakterit. Adhurimet bëhen vazhdimisht sepse njeriu është i hapur ndaj rrezikut vazhdimisht. Zot ruana! Të gjithë jemi në botë për t'u sprovuar, ndaj të mos mbahemi me të madh për asgjë, por të jemi falenderues e gjithmonë në lutje, duke kuptuar dobësinë njerëzore dhe duke u strehuar te mëshira dhe udhëzimi i Krijuesit Bujar!

Le të lutemi që Zoti të na mbrojë, të jemi pjesë e shumicës së mirë, shumicës që ndonjëherë mund të jetë kualitative, apo edhe kuantitative... por që është shumicë, qoftë edhe në raport cilësor!





1

TAKIM PUNE ME PËRFAQËSUESIN E BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë gjithashtu, priti në një takim përfaqësuesin e Bankës Islamike për Zhvillim, Mohamed Ahmed Salm. Takimi u zhvillua në kuadër të finalizimit të procedurave për fillimin e zbatimit të projektit të namazgjasë së Elbasanit. Z. Spahiu dhe përfaqësuesi i Bankës Islamike shprehën gatishmërinë që bashkëpunimet ndërmjet dy institucioneve të intensifikohen edhe më shumë në të ardhmen.

2

TAKIM PUNE ME MYFTIUN E ELBASANIT

Kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu dhe Drejtori i Vakëf/Investimeve dhe Financës, z. Edison Hoti, pritën në një takim pune Myftiun e Elbasanit, z. Agim Duka, së bashku me anëtarët e këshillit të kësaj myftinie.

Fokusi i bisedës ishte investimi që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë pritet të nisë së shpejti në një pronë vakëf në qytetin e Elbasanit.

Ky investim pritet të jetë një objekt me njësi tregtare dhe shërbimesh të ndryshme në një prej zonave qendrore të qytetit. Bashkërendimi dhe ndjekja e punëve në nivel qendror dhe lokal ishte tema kryesore e bisedës.





3

REKTORI I RI TË KOLEGJIT UNIVERSITAR "BEDËR" VIZITË KORTEZIE NË KMSH

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë kortezie Rektorin e ri të Kolegjit Universitar "Bedër", Prof. Dr. Gjergj Sinani, i cili shoqërohej edhe nga bashkëpunëtorë të tij.

Kjo vizitë erdhi në kuadër të zgjedhjes së Prof. Sinanit si Rektor i KU "Bedër", institucion i arsimit të lartë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Gjatë kësaj vizite, Kryetari Spahiu, i uroi rektorit të ri suksese në drejtimin dhe përmbushjen e përgjegjësiave institucionale në fushën e arsimit të lartë si dhe i garantoj atij mbështetjen e plotë nga institucioni që ai drejton.

Nga ana e tij, Prof. Sinani, shpalosi vizionin të cilin synon të implementoj në drejtimin e Kolegjit Universitar "Bedër" në vitet në vijim. Më tej biseda u fokusua në vitin e ri akademik i cili po afron.






4

TAKIM ME NËNDREJTORIN E PROJEKTEVE PËR BALLKANIN TË SHOQATËS KUVAJTIANE

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim, Mubarek Dusirij- nëndrejtor i projekteve për Ballkanin i shoqatës kuvajtiane, dega 'mëmë' e Sh. Mirënjohja, dhe z. Valid Salih.

Miqhtë nga Kuvajti u shoqëruan nga drejtuesi i Shoqatës Mirënjohja, dega Shqipëri, z. Samed Shehu dhe përfaqësues të tjerë. Gjatë takimit u diskutua ecuria e projekteve të përbashkëta dhe u ra dakord për të intensifikuar bashkëpunimin edhe në të ardhmen. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka bashkëpunim shumëvjeçar me Shoqatën Mirënjohja.





5

ZHVILLOI TRAJNIMI I PARË SHKENCOR FETAR NË BASHKËPUNIM ME MINISTRINË E ÇËSHTJEVE FETARE TË ARABISË SAUDITE

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi Trajnimin e Parë Shkencor Fetar në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite.

Në ceremoninë e hapjes, njëkohësisht edhe ditën e parë të trajnimit, ishin të pranishëm H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Amir al-Anezi, Atasheu Fetar i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje, Dr. Fehd el-Fuhejd, profesori trajnues i seminarit, Myftiu i Tiranës, Lauren Luli, si dhe imamë, hoxhallarë, muezinë të shumtë të Myftinisë Tiranë dhe Elbasan.

Në fjalën e tij hapëse, Kryetari Spahiu, pasi ju uroi të pranishmëve mirëseardhjen në këtë trajnim fetar tre ditor, tha se bashkëpunimi jonë i ngushtë sa i përket çështjeve fetare, aspektit të përgatitjes së kapaciteteve dhe infrastrukturës, është tregues i një rëndësie të veçantë të marrëdhënieve midis dy

Më tej, ceremonia e hapjes vijoi me fjalën përshëndetëse të Atasheut Fetar të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje, z. Amir al-Anezi, i cili vlerësoi lart bashkëpunimin e deritanishëm me KMSH-në, bashkëpunim i cili është frut i punës së nisur që në vitin 2019 dhe që synon të konkretizohet edhe më tej në të ardhmen me zhvillimin e konferencave, konkurseve të Kuranit, etj.

Pas fjalës përshëndetëse të Atasheut, trajnimi vijoi me referimin e Dr. Fehd el-Fuhejd, mbi dy vepra, njëra mbi besimin dhe tjetra mbi etikën dhe vlerën e dijetarëve. Referim i cili vijoi për tri ditë me radhë në ambientet e Kolegjit Universitar "Bedër".

Pjesë e këtij programi të organizuar nga KMSH ishin edhe ligjëratat fetare të mbajtura nga Dr. el-Fuhejd në xhami të ndryshme të kryeqytetit.

Në ceremoninë e mbylljes së këtij trajnimi, e cila u zhvillua më 07. 09. 2022, u shpërndanë edhe certifikatat e pjesëmarrësve për të pranishmit në trajnim nga Kryetari Spahiu, Atasheu Amir al-Anezi dhe Dr. Fehd el-Fuhejd.

Ky trajnim erdhi në kuadër të marrëveshjes së firmosur më herët ndërmjet dy institucioneve, Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, marrëveshje e cila parashikon zhvillimin e një sërë aktivitetesh të tilla të përbashkëta.

Në këtë program morën pjesë rreth 100 imamë nga myftinia e Tiranës dhe ajo e Elbasanit, me synimin që në trajnimet e radhës harta e përfshirjes të zgjerohet edhe më tej.





Islami

**NUK ËSHTE
RËNDESE PËR
ASKËND**

"Islami nuk është rëndesë për askënd." Kjo aksiomë e rëndësishme e besimit dhe e mënyrës së rregullimit të marrëdhënieve në Islam, është autostrada më e hapur shpirtërore për këdo që Allahu xh.sh. i ka falur mundësinë për të njohur të vërtetën, për të qenë në rregull me vetveten dhe bashkësinë.

Në emër të këtij Ligji Islam edhe brenda caqeve laike, në emër të të cilit paraqitet shtetit shqiptar, myslimanët mund të gjejnë rrugët e tyre për të qenë në linjë me vetveten, për të shfaqur besimin dhe për t'u integruar "në botën moderne".

Por a është shfrytëzuar qetësia islame nga myslimanët shqiptarë për të gjetur zgjidhjet e duhura dhe në momentin e duhur?

Në shumë raste myslimanët shqiptarë ndihen të shokuar kur dikush i sulmon te simbolet, kur dikush i quan fundamentalistë, apo kur dikush, për hir të uljes së kokës në sexhde, i cilëson të prapambetur.

Të futur në guaskën e tyre të besimit, të debatit vetëm me vëllain mysliman, pa kurrfarë vëmendjeje ndaj asaj pjese që nuk njihet me këtë të vërtetë (ose, thënë më shkoqur, që Allahu xh.sh. nuk ia ka hapur zemrën për këtë të vërtetë), praktikuesit e besimit islam gjenden shpeshherë disa hapa pas ndaj asaj që ndodh me ta dhe rreth mënyrës së tyre të jetesës. Të gjendur më së shumti të vetëlarguar nga pjesa joislame, pa provuar kurrfarë zgjidhjeje për të përfituar prej tyre atë që kanë kërkuar në emër të besimit, myslimanët i krijojnë vetvetes vështirësinë e fillimit të sqarimit të gjërave nga minimumi i mundësisë për të arritur një rezultat, nga minimumi i mundësisë për të dialoguar me argumente, e aq më keq, kur kundërshtari ka vendosur të logjikojë me dëshirën për të të kundërshtuar apo për të të fyer.

Islami nuk është traditë në emër të mbiemrit që të shënon një punonjësi i gjendjes civile. As testament i gjyshit, i ngjashëm me pronësinë mbi tokë ose dhe nën tokë. Islami në lidhje me individët

është testament që për çdo besimtar fillon dhe mbaron brenda caqeve të asaj që i është caktuar atij, brenda kohës së provës së kësaj jete për të dhe me gjykes të vetëm e të përhershëm Allahun xh.sh. Ndaj dhe mënyra se si do të krijosh marrëdhëniet me Të dhe në emër të Tij varen nga kushdo që ka vendosur të integrohet nëpërmjet të vërtetës islame dhe rrugëzgjidhjeve islame.

Por gjetja e rrugëzgjidhjeve fillon nga besimi që këto rrugëzgjidhje ekzistojnë. Të mosqenët rëndesë për askënd është fillesa e çdo besimtari për të besuar se zgjidhjet janë kudo dhe kurdo, brenda

lirisë, brenda mundësisë për të ruajtur vetveten nga fyerjet, e aq më shumë besimin tënd.

Vetë i Dërguari a.s. ka pranuar ndihmën e jobesimtarëve (rasti kur është ndihmuar me ndonjë prej kurejshëve idhujtarë apo emigrimi i parë i shokëve të tij drejt Abisinisë, që në atë kohë ishte e krishterë). Ka pranuar të komunikojë me ta, të integrohet me ta.

Kjo është vetëm një shenjë për të na treguar se

çdo mysliman nuk mund t'i shmanget integritetit në jetë, në kohë dhe me bashkëkombësit e tij. Pas këtij hapi çdo mysliman mund të punojë me qëllimin dhe shpresën e vetme tek Allahu xh.sh. se mund të bëhet shkak për ndonjë apo disa prej tyre për të përqafuar Islamin.

Për të besuar në zgjidhje së pari duhet të besojmë se ato na janë dhënë. Dhe për t'i korrur këto zgjidhje në jetë duhet të mos shmangemi në asnjë çast nga integriteti.

Vetëm pasi ne të kemi treguar në marrëdhëniet me shoqërinë përparësitë e Islamit, tolerancën e Islamit, lirinë e Islamit, atëherë ne mund të shmangim reagimet spontane, mund të përgatisim atë gjendje ku askush të mos guxojë t'i afrohet simboleve të besimit, qoftë për hir të bindjeve të tij ateiste apo besimit të cilit i përket.

Myslimanët kanë nevojë të shfaqin dhe të mbrojnë dinjitetin që të fal Islami.

Vetëm pas hapit të sinqertë në besim burojnë zgjidhjet.

Për të krijuar atmosferën që i takon mbrojtjes së këtij dinjiteti dhe të vërtete nevojitet së pari t'i hapim udhë mendimit që buron nga liria islame, nga toleranca dhe rrugëzgjidhja e pafund e Islamit.

"Islami nuk është rëndesë për askënd" është vetëm fillim i zgjidhjes. Për t'u bërë edhe fund i mënyrës sonë të jetesës duhet fillimisht ta besojmë, pastaj ta studiojmë, pastaj ta diskutojmë, e më pas edhe ta shpërndajmë.

Për një liri të tillë myslimanët nuk mund t'i pengojë asnjë shtet, pasi këtë të fundit, nëse nuk cenon bazat e besimit, duhet ta pranojmë, edhe nëse në ndonjë rast ai nuk na vjen për shtat. Mjafton të besojmë se "Islami nuk është rëndesë për askënd", për të kuptuar që në atë moment duhet t'i rikthehemi vetvetes dhe të shënojmë "gradët" me të cilat duhet të ecim dhe "temperaturën"

me të cilën duhet të komunikojmë. Këto të gjitha do të bënin që, minimalisht të mos na fyhej besimi, të mos gjendeshim të shokuar dhe krejtësisht spontanë në mënyrën e reagimit. Ndërsa pak më tej, nëpërmjet tolerancës dhe zgjidhjes islame, çdo ligj laik mbetet vetëm në atë ligj jashtë Islamit dhe për ata njerëz jashtë këtij besimi.

Një mysliman që beson në këto zgjidhje, që Allahu xh.sh. i ka falur mundësinë për të qenë jashtë injorancës, nëpërmjet angazhimit në dije, duhet të fillojë të shtrijë të drejtën e tij, që ia jep Islami, për të qenë dinjitoz përpara të tjerëve, sidomos për sa i përket asaj pjese që ai beson se është në hullinë e të drejtës që i fal Krijuesi i gjithë botëve.

Mjafton që fillimisht të besosh në zgjidhjet. E po të punosh edhe për t'i kuptuar dhe praktikuar ato, atëherë nuk ka se si dhe pse të gjendemi mes spontanitetit, zhgënjimit, e aq më pak dështimit.

"Islami nuk është rëndesë për askënd" është aksiomë që shërben për çdo rrafsh të mendimit dhe veprimtari njerëzor, pavarësisht nga pikat e globit apo kohën e funksionimit.

Sahabja e nderuar
DURRETU BINT EBI LEHEB

A keni dëgjuar më parë për sahaben e nderuar Durretu Ebi Leheb, Allahu qoftë i kënaqur prej saj?

A e keni dëgjuar fjalën e Profetit Muhamed a.s. për të drejtën e saj:

“Nuk duhet shqetesuar i gjalli për të vdekurin.”?

Ajo sahabe e nderuar është vajza e xhaxhait të të dërguarit të Zotit a.s!

Babai i saj ishte Ebu Lehebi dhe Nena e saj ajo që mbarte dru e ferra për të penguar në rrugë të dërguarin e Zotit a.s, motra e vellezërve Utbe dhe Utejbë, e megjithatë, e duam dhe themi prej më shumë se 1400 vitesh pas vdekjes së saj: Allahu qoftë i kënaqur me të! Kjo është feja që porositi për drejtësi dhe e praktikon sahabja e nderuar heshimije, Durretu bint Ebi Leheb.

Prinderit e kësaj sahabeje i njoftoi shpallja hyjnore, Kurani Kerimi për dënimin me zjarr! Ndërsa ajo perqafoi Islamin dhe u largua nga prindërit e saj!

U largua Durretu nga shtëpia dhe nga vendi i saj për hir të Islamit, dëshmoi Shehadetin dhe emigroi me besimtarët e tjerë për në Medine.

Nderkohë që kjo arriti në Medine i propozoi për martesë sahabiu i famshëm Duhaje El Kelbij dhe u martua me të!

Më përpara se të pranonte Islamin ishte e martuar me Harith ibn Noufel ibn Abdulmutalib dhe kishte me të tre fëmijë me emrat Ukbetu, Eluelijd dhe Ebu Muslimi, dhe bashkeshorti i saj që u vra si idhujtar në betejën e Bedrit në të cilën Allahu ndihmoi Islamin dhe poshtëroi mosbesimin!

Pasi perqafoi Islamin, Zoti i dha asaj një bashkëshort të shkelqyer, ndër më të bukurit dhe më të pashmit, që shkëlqente bukuria e tij, sa që zbriste Xhibrili (a.s.) nga qielli në formën e këtij njeriu, pra shiko çfarë mirësie për të!

Një ditë disa gra të fisit Beni Rruzejk i thanë: Ti je vajza e Ebu Lehebit e ç'dobi ke nga emigrimi, pasi për babain tënd ka zbritur ajeti “Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi...”?

Shkoi te Profeti Muhamed (a.s.), duke ia treguar çështjen dhe ai i tha: “Ulu”. Fali namazin i Dërguari me të pranishmit dhe më pastaj u ul mbi minber dhe tha: “O ju njerëz, si është puna që disa po më shqetësojnë me të afërmit e mi e gjakun tim dhe tha:

“Nuk shqetësohet i gjalli për të vdekurit!”

Gjatë jetës së saj ajo forcoi lidhjet me nënën e besimtarëve Aishen (r.a.), shkonte shpesh tek ajo që të merrte njohuri të sakta mbi fenë.

Vdiq në vitin 20 të hixhretit në kohën e kalifatit të Omer Ibn Hatabit.

Mos u arsyeto me faktin që vendi apo kushtet nuk të mundësojnë të praktikosh fenë dhe besimin, nuk ka ndonjë bashkëkohës më të keq sesa ishte Ebu Lehebi dhe nuk ka familje që luftonte Islamin sa familja e Ebu Lehebit.

Kapuni pas fesë tuaj dhe dijeni: “Dhe atyre që u udhëzuan ua shtoi udhëzimin dhe ua jep devotshmërinë” Kurani Kerim.

“Dhe njeriut i takon përpjekja e tij, dhe përpjekja e tij do të shikohet dhe do të shpërblehet ashtu siç e meriton!”

E njohe tashmë se kush ishte Durretu (r.a.)?

Lidhja mes **Resulullahut** dhe **Umetit** të tij





Lidhja mes Allahut dhe umetit të Profetit Muhamed (s.a.s.) i ngjan gjendjes së këtij njeriu: "Dikush ndërton një shtëpi të re, kësodore për shtëpinë e re shtron një gosti, e natyrisht për t'i ftuar njerëzit që ka vendosur të tubojë, dërgon një lajmëtar. Ata që i përgjigjen ftesës, futen brenda dhe përfitojnë prej gjithë të mirave të shtraura në atë gosti. Ndërsa ata që nuk vijnë, as nuk e shohin dot shtëpinë e re, e as nuk shijojnë dot prej ushqimeve të gostisë." Mësimi i këtij shembulli është ky: ajo shtëpi është Xheneti, i zoti asaj shtëpie është Allahu (xhel'le xhelaluhu), lajmëtari që çon ftesën është Muhamedi (alejhis'salatu ues'selam). Ai që i përgjigjet ftesës së Tij cilësohet se i është bindur Allahut (xh.sh.), ndërsa ai që nuk i përgjigjet është ai që ka kundërshtuar Allahun e Madhërishëm. Profeti ynë i nderuar (paqja e Zotit qoftë mbi Të) ka shpërfaqur dallimin në mes njerëzve (atyre që besojnë dhe atyre që nuk besojnë).¹

Po ende Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shprehet kështu: "Gjendja ime me ftesën që Allahu Fuqiplotë ka dërguar përmes meje i ngjan gjendjes së atij njeriut, që: Një burrë shkon njëherë pranë të afërmeve të tij dhe u thotë: 'Unë i pashë ushtritë e armiqve me këta dy sy, kështu që po ju bëj të ditur rrezikun që ju kanoset, duhet të merrni menjëherë të gjitha masat!' - Një pjesë e popullit e dëgjon këshillën e tij, e me të rënë nata, i mbledh gjithë ç'ka dhe largohet paq. Kurse pjesa tjetër nuk ia vë asfare veshin fjalëve të tij, madje edhe i përgënjeshtrojnë, duke mos lëvizur aspak nga vendi. Mirëpo, vjen mëngjesi dhe që të gjithë zihen robër dhe vriten nga ushtria armike. Ja, ky shembull e paraqet më së miri ndryshimin mes atyre që u binden fjalëve të mia dhe atyre që nuk i pranojnë ato, madje edhe i mohojnë ato që unë i kam sjellë prej Allahut të Madhërishëm."²

Muhamedi, paqja e Allahut qoftë mbi Të, shprehet: "Historia ime është si ajo historia e atij burrit që ndez një zjarr. Kur zjarri bëhet bubulak e zë të ndriçojë rreth e rrotull, fluturat dhe disa gjallesa të tjera, që e duan dritën, vërsulen për t'u hedhur në mes të flakëve. I gjori burrë, ç'të bëjë, orvatet të bëjë ç'të mundë, që t'i pengojë, por ato fillojnë të hidhen tufa-tufa drejt e në zjarr. Edhe unë, porsi ai burri, ju tërheq ju nga pas, që ju të mos bini në flakët e zjarrit, kurse ju vazhdoni të rendni me sa të mundni drejt tyre."³

1. Buhari, *Sabih*, 6/2655.

2. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/60.

3. Buhari, *Sabih*, 5/2379.

Ajete rreth Profetit (a.s.) dhe sahabëve të tij

"A nuk i sheh ata të cilët, edhe pse iu është ndaluar të kurdisin fshehtësisht, kthehen tek ajo që u është ndaluar dhe kurdisin për gjynahe, armiqësi dhe mosbindje ndaj të Dërguarit? Kur vijnë te ti, ata të përshëndesin me fjalë, me të cilat Allahu nuk të përshëndet kurrë dhe thonë me vete: "Pse nuk na dënon Allahu për këtë që po flasim?" Xhehenemi është një dënim i mjaftueshëm për ata. Në flakët e tij do të digjen. Eh, sa vendbanim i tmerrshëm që është ai! O besimtarë! Kur të bisedoni fshehtas mes jush, mos flisni për gjynahe, armiqësi dhe mosbindje ndaj të Dërguarit; por bisedoni për mirësi dhe drejtësi. Kijeni frikë Allahun, para të Cilit do të tuboheni." (Fet'h, 58/8-9)

Një umet i mbarë dhe i ekuilibruar

"Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri i tyre, Ne do të të sjellim ty (Muhamed) dëshmitar kundër këtyre. Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët." (Nahl, 16/89)

"Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju. Ne nuk e kemi bërë kthimin tënd nga Qabeja (o Muhamed) për tjetër arsye, por vetëm për t'i dalluar ata që i shkojnë pas të Dërguarit, nga ata që kthehen nga thembrat (që tërhiqen nga besimi tek ai). Kjo provë ka qenë e rëndë (për njerëzit), por jo për ata që Allahu i ka udhëzuar. Dijeni se Allahu nuk ua humb besimin tuaj (d.m.th. namazin që keni falur nga Kudsi). Në të vërtetë, Allahu është Përdëllimtar dhe i Mëshirshëm me njerëzit." (Bekare, 2/143)

"Luftoni në rrugën e Allahut, ashtu si duhet luftuar. Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj, fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai ju ka quajtur juve myslimanë qysh më parë (në Shkrimet e Shenjta) dhe në këtë (Kuran), me qëllim që i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju dhe që ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit e tjerë. Andaj, faleni namazin, jepni zeqatin dhe mbështetuni tek Allahu! Ai është Mbrojtësi juaj. Sa Mbrojtës dhe Ndihmës i mrekullueshëm është Ai!" (Haxh, 22/78)

Profeti i një umeti të mbarë dhe të ekuilibruar

"Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar." (Al 'Imran, 3/164)

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët." (Teube, 9/128)

"Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed)! Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ta për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai." (Al 'Imran, 3/159)

Veçoritë e sahabëve të tij janë të shkuara edhe në Teurat e Ungjill

"[...] dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe në Ungjill. Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat, duke i liru nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit." (Araf, 7/157)

"Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh." (Fet'h, 48/29)

Si vlerësohen sahabët në Kur'anin Famëlartë

"Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore." (Teube, 9/100)

"Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpërbleu me një fitore të afërt e me një plaçkë të madhe që do ta fitojnë. Allahu është i plotfuqishëm dhe i Urtë." (Fet'h, 48/18-19)

"Pa dyshim, Allahu e pranoi pendimin e të Dërguarit, të muhaxhirëve dhe të ensarëve, të cilët shkuan pas atij në çastin e vështirë, pasi zemrat e disave prej tyre për një fije qenë afër shmangies (nga detyra), pastaj Allahu pranoi pendimin e tyre. Vërtet, Ai është i Butë dhe i Mëshirshëm me ta." (Teube, 9/117-118)

Sahabët: përmendore të besnikërisë dhe singeritetit në besim

"Një pjesë e plaçkës u takon edhe mërgimtarëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e singertë. Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndiejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues." (Hashr, 59/8-9)

"Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre." (Ahzab, 33/23)

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"
M. Jusuf Kandeheui
Botim i KMSH**





Kur fillova ta dua veten

Kur fillova ta dua veten, zbulova se ankthi dhe vuajtja emocionale ishin vetëm shenja paralajmëruese, se po jetoja kundër të vërtetës sime.

Sot, unë e di që ky është "ORIGJINALITETI".

Kur fillova ta dua veten, kuptova se sa shumë mund të ofendohet dikush, kur unë përpqem të imponoj dëshirat e mia te ky person, edhe pse e dija që koha nuk ishte e duhura, dhe ky person nuk ishte gati, dhe ndonëse ky person isha unë. Sot unë e quaj "RESPEKT".

Kur fillova ta dua veten, pushova së dëshiruari një jetë të ndryshme dhe nisa të shoh se gjithçka që më rrethonte, po më ftonte të rritesha. Sot, unë e quaj "PJEKURI".

Kur fillova ta dua veten, kuptova që në çdo rrethanë, unë jam në vendin e duhur, në kohën e duhur, dhe çdo gjë ndodh saktësisht në momentin e duhur. Kështu që mund të jem i qetë. Sot, unë e quaj "VETËBESIM".

Kur fillova ta dua veten, ndalova së vjedhuri kohën time dhe pushova së hartuari projekte të mëdhenj për të ardhmen. Sot, bëj vetëm atë që më sjell gëzim dhe lumturi, gjërat që më pëlqen t'i bëj dhe që e bëjnë zemrën time të ngazëlletet, dhe i bëj në mënyrën time

dhe sipas ritmit tim. Sot unë e quaj "THJESHTËSI".

Kur fillova ta dua veten, u çlirova nga çdo gjë që nuk është e mirë për shëndetin tim - ushqimi, njerëzit, gjërat, situatat, dhe çdo gjë që më vinte përfund dhe më largonte nga vetvetja. Në fillim, këtë sjellje e quaja egoizëm të shëndetshëm. Sot, e di që është "DASHURI PËR VETVETEN".

Kur fillova ta dua veten, pushova së përpjekuri për të pasur gjithmonë të drejtë dhe që atëherë, kam qenë gabim, më rrallë. Sot zbulova që kjo është "MODESTI".

Kur fillova ta dua veten, pushova së jetuari në të kaluarën dhe së shqetësuar për të ardhmen. Tani jetoj vetëm për momentin, ku ndodh GJITHÇKA.

Sot unë jetoj çdo ditë, dhe e quaj "PËRMBUSHJE".

Kur fillova ta dua veten, kuptova se mendja ime mund të më trazojë dhe mund të më sëmurë. Por pasi e lidha me zemrën time mendja ime u bë një aleat i vyer. Sot, këtë lidhje unë e quaj "URTËSIA E ZEMRËS".

Nuk kemi më nevojë t'u trembemi debateve, përballjeve, apo problemeve me veten dhe të tjerët. Edhe gjatë bien dhe atje ku përplasen, lindin botë të reja. Sot, unë këtë e quaj "JETË".

PSE DUHET TË JEMI SHEMBULLI I NJË moralit të bukur?

"Asnjë prind nuk mund t'i lërë fëmijës së tij një trashëgimi më të mirë se sa morali i bukur."
(Tirmidhiu, Birr, 33)

Nuk ka asnjë fe apo sistem tjetër që e ka vlerësuar moralin e mirë aq sa feja jonë Islame. Në këtë kuptim, Pejgamberi (a.s.) tha: "Islami është moral i mirë". Të kesh moral të mirë është manifestimi më i mirë i të qenit musliman. I Dërguari i Allahut ka shumë fjalë të bukura që nxisin moralin e mirë.

Për shembull ai ka thënë se "Besimtari më i pjekur në besim është ai i cili zotëron moral të mirë", dhe kjo tregon për ndikimin që ka morali i mirë mbi besimin. Po ashtu Pejgamberi (a.s.) në hadithin e mëposhtëm na tregon se mënyra më e mirë për të qenë afër tij është të jemi me moral të bukur: "Ata që i dua më së shumti dhe që do jenë më afër meje në Ditën e Gjykimit janë ata me moralin më të mirë."

Në librin tonë të shenjtë, në Kur'an ka shumë ajete të cilat nxisin shembullin e një morali të mirë me anë të drejtësisë, mbajtjes së premtimeve, të qenit falës, përlulesisë, bindjes ndaj prindërve, besueshmërisë, dashurisë, vëllazërisë, paqes, vërtetësisë, bujarisë, mëshirës, tolerancës, fjalëve të buta, humorit të mirë dhe zemrës së pastër. Mirëpo, ka edhe shumë vargje që ndalojnë zakonet dhe sjelljet e këqia si: mizoria, kotësia, zilia, përgojimi, fjalimi vulgar, mërzia, koprracia, egoizmi, xhelozia, mendjemadhësia, inati, dyshimi i keq, ekstravaganca dhe keqbërja. Të gjitha këto tregojnë se sa rëndësi i jep feja jonë moralit të mirë.

Atëherë pse duhet të kemi moral të mirë? Le ta trajtojmë këtë në disa pika:

Sepse feja jonë i ka dhënë rëndësi të madhe marrëdhënieve ndërpersonale si dhe adhurimit, dhe nuk është e mundur që ata që nuk kanë moral të mirë ta jetojnë fenë e tyre plotësisht.

Sepse vetë Pejgamberi ynë përfaqësonte moralin e mirë. Për t'u përgatitur për në Xhenet, është e nevojshme të moralizohemi me moralin e tij. Allahu përmend në Kur'an se Profeti është shembulli më i mirë për të gjithë besimtarët. Në një ajet tjetër thuhet: "Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali". Megjithatë, është e mundur të jetohej ashtu siç ka jetuar ai vetëm duke e pasuar moralin e lartë të Pejgamberit tonë.

Sepse një besimtar mund të ngrihet në nivelin e njerëzve që janë thelluar në adhurim me moral të mirë. Profeti ynë (a.s.) e shpjegon këtë në një nga hadithet e tij: "Falë moralit të mirë, një njeri mund të arrijë në gradën e një personi që falet natën dhe një agjëruesi i cili qëndron i etur në vapë përvëluese." Kjo nuk duhet keqkuptuar. Adhurimi është shumë i rëndësishëm në aspektin e shfaqjes së nënshtrimit ndaj Allahut. Megjithatë, një besimtar që jeton mes njerëzve duhet të respektojë edhe sjelljet, e duhet t'u kushtojë

vëmendje marrëdhënieve ndërpersonale. Kur ai e bën këtë, me fjalë të tjera, kur ka moral të mirë, adhurimi i tij do të përmbushet në kuptimin më të përsosur dhe të plotë.

Sepse morali i mirë i mundëson besimtarit të hyjë në Xhenet. Kur i Dërguari i Allahut u pyet për veprat që do t'i vendosin njerëzit më së shumti në Xhenet, ai tha: "Takvaja (vetëdija) ndaj Allahut dhe morali i mirë."¹ Kjo tregon se sa i rëndësishëm është morali i mirë së bashku me adhurimin dhe se ato mbartin një veçori që do t'i çojë njerëzit në Xhenet.

Sepse morali i mirë tregon se imani dhe besimi² janë të pjekur dhe të përsosur. Pejgamberi ynë flet për dy tipare që nuk mund të gjenden tek një besimtar dhe thotë se këto janë koprracia dhe morali i shëmtuar. Përsëri, Profeti thotë se besimtarët më të mirë në aspektin e besimit janë ata që janë më të mirë në moral.

Morali i mirë është edhe bindje ndaj Allahut. Me fjalë të tjera, të kesh moral të mirë do të thotë të adhurosh. Sepse Profeti tha se adhurimi më i lehtë për t'u bërë pa u lodhur është të mos flasësh fjalë boshe dhe të kesh moral të mirë.

Sepse morali i mirë është shenjë e dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij të dashur. Hadithi, i cili thotë se ata që janë më të afërt me Profetin tonë në Ditën e Gjykimit do të jenë ata me moralin më të mirë, e zbulon këtë qartë. Kur Allahu e do një rob, Ai i dhuron atij moral të mirë.

Sepse morali i mirë bën që te njeriu të largohen mëkatet ashtu siç shkrin dielli acarin. Ashtu si uji shkrin akullin, morali i mirë shkrin mëkatet. Pejgamberi ynë thotë se morali i keq do t'i prishë veprat e mira, ashtu siç uthulla prish mjaltnin.

Atëherë edhe lutja më e mirë në këtë rast do të ishte të luteshim sikurse është lutur i Dërguari ynë: "O Zoti im! Kërkoj nga Ti të më bekosh me shëndet, mirëqenie, të më bësh që mos të tradhtoj amanetin, të më bësh me moral të lartë dhe të më bësh të jem i kënaqur me përcaktimin Tënd! O më i Mëshirshmi i mëshiruesve! Për hir të mëshirës [Tënde], m'i jep këtë!"

Përktheu: Haki Sahitaj

1. Tirmidhiu, *Birr*, 62.

2. Në origjinal 'iman' dhe 'inanç'. Të dy fjalët në gjuhën shqipe përkthehen si besim, por ka një dallim mes tyre. Imani ka të bëjë me çështjet absolute të besimit apo doktrinës islame, ndërsa 'inanç' apo besim ka të bëjë me të gjitha çështjet tjera të cilat ne i besojmë si të vërteta nga përvoja apo faktet në të cilat kemi arritur, por që mund të mos jenë absolute. Si p.sh kur themi: Besoj (inanıyorum) se ky mendimi është më i saktë. Ky mund të jetë një besim i imi, por jo domosdoshmërisht i gjithkujt për atë çështje (Shënim i prkth).

SIKUR E VËRTETA ËSHTË PËR DIKË TJETËR, E JO PËR NE

Enes ibn Maliku përcjell se i Dërguari i Allahut me një rast as'habëve të tubuar u mbajti fjalimin vijues:

“O njerëz, sikur vdekja në këtë botë i është caktuar dikujt tjetër, e jo neve, sikur e vërteta është për dikë tjetër, e jo për ne, a thua se ata me të cilët ndahemi pak para çastit të vdekjes, janë udhëtarë që së shpejti do të kthehen, ne i lëmë në varret e tyre, kurse trashëgiminë prej tyre e shfrytëzojmë thuajse nuk do të vdesim kurrë. E harrojmë çdo këshillë. Ndihemi të sigurtë nga çdo fatkeqësi.

Lum kush preokupohet me mangësitë e veta, e nuk i hulumton mangësitë e njerëzve të tjerë!

Lum kush ndan pasurinë e fituar me nder, kush rri me njerëzit e ditur e të urtë dhe kush shoqërohet me botën e varfër e të mjerë!

Lum kush ka karakter të mirë dhe ndërgjegje të pastër dhe lum kush nga e keqja e të cilit janë të sigurtë njerëzit e tjerë!

Lum kush ndan tepricën e pasurisë së tij, kush përmbahet nga të folurit e tepërt dhe kush i përmbahet Sunetit dhe u ruhet risive (bid'ateve) në fe.”

**Marrë nga libri “Hutbe të zgjedhura të Profetit
Muhamed (s.a.s.)
Dr. Jusuf Ramiq
Botim i KMSH**



Qytetnrimi'i çalë

Qytetnimi modern, me gjithse larg qëllimit të tij të vërtetë, ende vazhdon të bajë hapa përparimi të shëndosha. Disa elemente të natyrës janë sjellë nën kontrollin e njeriut, bile mund të pretendohet t'i qeverisë, me gjithse në mënyrë të kufizuar, tokën, ujin, zjarrin e ajrin. Elektri ka hye nën shërbimin e tij dhe dita është afër kur yjet, në radhën e tyre, do të veprojnë një soj sikur është zbuluar në Kuran (kaptina 16 vers. 12).

Gjendja e paraqitur në Perëndim është tue brejtun trupin e njerzimit, dhe se doemos s'do të shkojë shumë kur t'a udhëheqë në venitje fizike në një gradë që të mos i ngelë fuqi ose kuxim për përparime ma të alta. Në se mendja e shëndoshë është fëmija e një trupi të shëndetshëm, ky i fundit në radhën e tij, ia detyron ekzistencën e vet moralit të saktë. Çdo degë e qytetnimit në botën perëndimore ka këthye ose është tue u ndërrue në mëmën e të keqes – e keqe kjo që mbrenda dy tre brezash do të sjellë paralizimin fizik të racës njerzore, e kështu krejt përparimi do të ndalojë. Le të marrim parasysh për shëmbëll efektin e sëmundjeve veneriane (ngjitëse). Mbi këtë subjekt ka shkruar në New York një libër Mr. Kidwai, ku thotë: "Në krahinën e të ndershmit Dr. Holmes rezultati i mos frenimit të instinktit seksual nga ndonjë fe e fuqishme dhe efektuese është se pesë milion vepra prostituti janë tue ndodhë

çdo vit, dhe 98 për qind të prostituteve janë efektue me sëmundje veneriane, me gjithse Ligji i Shteteve të Bashkueme është mjaft i rreptë kundër prostituteve në çdo formë qofshin. Ashtu regjistruar se 225000 fëmijë të paligjshëm lindin çdo vjet vetëm në New York; 2 500 000 sëmundje sifilisi mjekohen për çdo mot, dhe një milion e gjysmë fëmijë të palindun mbyten në barkun e mëmave çdo vjet në Amerikë. Këto janë statistika alarmuese, por të bazuar për burime autentike. Këto janë përfundimet e instinkteve seksuale të çfrenueme nga feja".

"S'ka shumë, në Qershter të vitit 1929 Mr. Gover Whalen, Komiser i Policisë së New York-ut një herë shprehu se krimi ishte tue u shtue vazhdimisht në të katër anët e Shteteve të Bashkueme. Ai deklaroi se ishte barazishtë e lehtë me pastruar salonet e vjetra ose shtëpitë publike pse ato ishin në shesh. Sot kemi 32000 kabare në qytetin e New Yorkut, të cilat ai i përshkroi si vendi ku buronin krimet e prostitutit. Asht e pa mundun me çrranjos lokalet kësodore", tha ai "sepse ato mbijshin edhe natën pors i kërpuhat".

Tue marrë parasysh të gjitha këto të zeza, që i vijnë njerzimit e bajnë të ditshmin të mendohet një fije për të ardhëshmen e një qytetnimi të tillë. Në Perëndim ka një mungesë të madhe në përqindjen e lindjeve dhe

brazat që vijnë ka gjasë të jenë të një race të dobët e të degjenerueme, të dënueme për t'u fikun shpejt a vonë.

Shkenca mjeksore asht tue pregatit mënyrën e shërimit për t'a mjekue këtë sëmundje. Mund të dalë me sukses në përpjekjet e saj dhe të korë akoma ngadhnjime të tjera, por ato duhet pa tjetër të provojnë një rrezik për shëndetin me kalim kohe. Do të veprojë si një falje fizologjike e përkohshme, jo ma pak të rrezikshme për mirëqenien morale se sa ajo shpirtnore dhanun njerzimit me anë të fesë formale.

Frika e ndëshkimit asht një ndalesë efektive për të keqen mbi këtë tokë. Na e gjejmë këtë të vërtetë të dukshme në frikën e ligjitt të sëmundjeve dhe të zemërimit që do të vijë. Në çdo rast e ka ndalue dallimisht vrullin e të keqes, por fatkeqsisht kultura perëndimore e ka ngritun damkën e krimit të ligat e ndryshme që anojnë me shkatrrue fabrikën shqnore. Doktrina e të falmes së mëkateve kanë ngritun frikën e dënimit që një mëkatar do të ketë në t'ardhëshme. Në se Pererëndimi asht ba ma i padrejtë se Lindja, asht për arsye se doktrina i vue mëkatit një lloj dhurate. Ndëshkimi nga natyra në formë të ndonjë sëmundje të tmerrshme ka udhëhqun në zbulimin e një mjekimi dhanun keqbamësit për me e mbrojt atë nga përfundime të rrezikshme shëndetsore. Zbulimi i një mjekimi të tillë kishte me ngrit nevojën e një kujdesi dhe i ep keq-punuesit letrën e bardhë të zhytet në epshet ma të poshtira shtazore. Pse të mos mendojmë na për ndonjë urdhën moral, që t'a ngren nevojën e një veprimi fizik në këtë pikpamje?

Po, ka edhe shumë të këqija të tjera përveç atyne të seksit, të cilat vijnë të kanosin mbi ngrehinën e qytetnimit të kombeve. Prap sifilisi, veremi dhe sëmundje të tjera të rrezikshme apin po ato përfundime e bile në një formë ma të frigëshme. Veç adylterisë së një natyre të çfrenueme janë edhe faktorë të tjerë, që ndihmojnë dekadencën e paevitueshme të një qytetnimi si ky. Pija, bixhozi, rrena, mashtrimi dhe grabitja me mjeshtëri, të korruptuem gjithashtu edhe nga i ashtuqujtuni seksi delikat; mbytja e negërve, vrasje, helmime, luftime, paragjykime race, kamatë, kapitalizëm – qëllim i të cilit asht me grabitë punën e një puntori që e ka hak – eksploatime e shumë të tjera. Mungesa e përfilljes së fëmijve dhe lanëja mbas dore e të gjitha lidhjeve morale e shoqnore n'emën të lirisë, janë ndër tiparet kryesore të kohës. Libertinizmi asht përzir me liri. Këto kondita paraqesin një pamje vajtuese dhe s'mund të bahen garant për vijimin e konditave të lumtënisë së dukëshme. Fati i Pompeit i pret shumë qytete të botës perëndimore. "Historija e jonë" thotë Signof the Times e Amerikës, "po shkon paralel me atë të imperatorive dhe të kombeve të tjera të historisë; fëlliqsija dhe epshet ei dërguen ata bashkë me venë, gra dhe kangë, në portat e skëtërrës e të shdukjes. Ato janë tue shtrure rrugën e tyne drejt orizonteve të ferrit po mbi këtë tokë të Zotit". A asht një histori kësisoj e

vlefshme për t'u marrë në konsderim? Dhe akoma për t'u mëshirue ma tepër asht fakti se po ata shkrimtarë që bisedojnë dhe shoshitin qytetnimm e tashëm janë kështu tue shpejtue shkatrrimin e tij.

Na s'kemi nevojë të kërkojmë ndonjë xhehennem ma të rreptë pse e kemi këtu, në qytetet e kësaj toke. Asht plaga morale e helmueme që ka infektuar të krejt sistemin. Mirë po ku e ka shërimin? Kultura materiale ka dështue kryekëput t'a gjejë atë; po një soj, mund të thohet edhe për intitutet që e përkrahin këtë. Tokat e kulturueme i ushqejnë dhe i rrisin këto vese të këqija. Amerika shpenzon miljona dollarë për misionet e saj me qëllim të përmirësojnë moralin e të tjerëve, porse nga ana tjetër i toleron demoralizimet.

Në krahasim të padallueshëm në mes të mësimëve të besimeve të ndryshme në këtë pikë to t'ishte pa dobi. Pema nijfet nga kokrrat e saj që nep. Lindja asht ma e pastër se Perëndimi dhe në popujt e Lindjes Muslimanët paraqitin një jetë ma të thjeshtë e të dliit, dhe se ky nuk asht një pohim i thatë. Faktet dhe figurat e vërtetojnë atë. Populli Musliman i lindjes asht i vorfën në gjanat e kësaj bote për shkak të shtypjes ekonomike të sunduesve të huej, të cilët me çdo mënyrë duen t'i mbajnë n'errësinë ma të madhe, tue mos i lanë shtek përparimi tue i qit para pengesat ma të mëdha. Me gjithë këtë janë perpetitët historike që nuk i lenë me çu krye Muslimanët nga shumë pikpamje. Me gjith që shumica e muslimanve banojnë në pjesën e krahinave të nxjehta, prap ata janë të shpëtue nga sëmundjet veneriane. Na sjemi të pasun, por ska të papunë në tokat Muslimane. Prindër të vorfën me fëmijë milionerë janë fenomene krejt të panjohura në Lindje e sidomos në Muslimanë.

Asht e lehtë me gjet shkakun e vërtetë të shërimit të këtyne plagve. Islami asht feja e jetës dhe parimet e saj praktike kanë prodhuar rezultate të kënaqshme. Kurani nuk asht një libër me parime morale të pazbatueshme që merren me idale të imagjinueme. Libri Islam dhe Mësimet e Muhamedit (a.s.) kanë një dallim të dukshëm. Ata as nuk reklamojnë mbi moralin në terma të përgjithshme as që humbin vehten në asgjasime filozofike. Islami nuk i ep mësimet e veta në formë të ngatrrueme e të pa kuptueshme por vepron ashtu sikundër ban një kurrug në odën anatomke që ep emnin dhe i gjen vend çdo nyje dhe nerve të keqe, vëzhgon me kujdes çdo çashtje individuale, zgjat dorën në pjesën e sëmurë e pastaj e ven atë nën shërimin mjeksor ose i gjen barin e posaçëm smundjes si mbas rastit. Një kritikues mund të dyshojë në këtë thanëje, por le të marrë për një moment në konsiderim konditat që ndodhen në botë në këtë pikë të zbulojë shkaqet. Islami asht një fe që mban rekordin. Pse-ja dhe si-ja e çashtjes gjiindet në parimet e tij, të cilat janë praktike dhe të përshtatshme me jetën. Rreth këtij subjekti mund të flasim edhe ndonjë herë tjetër.

"Kultura Islame", Gusht 1942, Nr. 12, fq. 349



DAUT BORIÇI
(1825-1896)

DIJETARI I SHQUAR ISLAM

Daut efendi Boriçi ishte jo vetëm një dijetar i shquar islam, por edhe një nga patriotët më të shquar të Rilindjes Kombëtare. Ai ka udhëhequr me atdhedashuri Komitetin Ndërkrahinor të Lidhjes së Prizrenit, si dhe Degën e Lidhjes për Shkodrën. Daut Boriçi shquhet për përkushtimin e tij në fushën e arsimit dhe edukimit.

Jeta

Daut Boriçi, sipas autobiografisë së tij, u lind në Shkodër me 20 dhjetor 1825. Vetë ai shënon se mësues mejtepi të parë ka pasur Molla Ferhatin, që ka jetuar në periudhën 1772-1844. Kjo shkollë fillore gjendej në Pazar të Vjetër dhe Dauti tetë-vjeçar e frekuentoi së bashku me vëllain, Salihin. Në ditarët e Boriçëve gjendet një vjershë me nota realiste e hoxhë Ferhatit, kushtuar dy vëllezërve Boriçi, Dautit e Salihit.

Sipas shënimeve të të atit, Dauti, pasi mbaroi shkollën fillore, fëmijërinë e kaloi pranë familjes. Në autobiografinë e vet Dauti shënon se që në vitin 1839 kishte filluar të mësonte arabishten dhe të merrte mësim teologjie nga myderrizët e mirënjohur të Medresesë së Qafës, institucion i themeluar nga Mehmet Pashë Plaku (Bushatliu). Nga dora e mësuesve të respektuar si Salih efendia i Madh, Molla Ahmet Hadri dhe Molla Sylo Fakja, si dhe të myderrizëve të huaj të shquar, u përgatit një kontigjent klerikësh që më vonë u afirmuan, duke nderuar veten, institucionin dhe vendin, si: Jusuf Tabaku, Ahmet Kalaja, Hasan ef. Podgorica, etj., ashtu si dhe vetë Dauti. Edhe në vitin 1845 e gjejmë në këtë medrese, pas kryerjes të së cilës u emërua imam i xhamisë së Draginit dhe që në atë kohë u quajt Molla Dauti. Pas dy vitesh shërbimi, me 1850 u nis për Stamboll dhe me 21 tetor u regjistrua në medresenë Çifte-Bash Kurshun, një nga medresetë e Sulltan Mehmetit të II-të. Gjatë studimeve ai bënte takime të shumta me bashkatdhetarë, si dhe kryente porosi për të siguruar libra të ndryshëm nga kryeqyteti osman në vendlindjen e tij. Një dëshmi të tillë na jep ai vetë, kur kujton se si në qershorin e vitit 1851 u takua tre herë me Mustafa Pashën, që ndodhej në Stamboll. Te ky student i ri, ish-sundimtari i Shkodrës, në një moshë të thyer dhe me eksperiencë të madhe jete, si dhe me një formim kulturor serioz, gjente një bashkëbisedues aq interesant e të përgatitur, sa që i propozoi që t'i jepte mësim private gjuhe e besimi të birit të tij, Riza Beut, në një

kohë që në kryeqytetin osman nuk mungonin pedagogë të shquar.[1]

Në sajë të konsideratës që fitoi në familjen e Bushatlliut, kur Dauti deshi të kthehej në Shkodër, u ngarkua nga Riza Beu si mbikëqyrës i pasurisë së trashëguar prej të atit në Shkodër, me një rrogë prej pesë lirash në muaj, një ndihmë e mirë ekonomike kjo për familjen e tij të madhe.

Hoxhë dhe mësues

Pasi mbaroi studimet dhe u kthye në vendlindje, filloi karrierën e mësuesisë në shkollën "Rushdije" në Pazar të Vjetër, hapur më 1858. Shkollës "Rushdije" i përgjigjet shkolla e sotme 9-vjeçare që për kohën ishte shkollë e tipit më të përparuar, e ndjekur nga shumë bij të familjeve të qytetit, kryesisht myslimanë, pa përjashtuar edhe familjet e krishtera.

Dëftesat e para, ku ai nënshkruan si kryemësues, i takojnë vitit 1863; një e tillë i është lëshuar nipit të tij, Musa Boriçit. Nënshkrimet e profesorëve, të vendosura në këtë dëftesë, dëshmojnë se në këtë shkollë jepnin mësim emra të tillë, si: Sali Efendiu, Ahmet Efendi Kalaja, Ahmet Efendi Basha, tre nga myderrizët e afirmuar të vendit (ky komision merrte në provim edhe kandidatët për mësues, që i shtroheshin një konkursi). Brenda një kohe të shkurtër ai ka arritur të bëjë emër për përgatitjen profesionale dhe rezultatet në përparimin e nxënësve, sa që me shkresën 14 tetor 1863 ai merr lavdërime nga Ministria e Arsimit. Ai u shqua edhe për aftësi në drejtim e organizim, kështu e shohim në rolin e zëvendës drejtorit të arsimit që më 1858, kur me këtë funksion, më 7 prill në emër të autoriteteve mbajti fjalimin e rastit, kur u hodhën themelet e Katedrales së Madhe në Shkodër, që ishte njëherazi edhe një shprehje solidariteti e tolerance e të gjithë qytetarëve myslimanë ndaj bashkëqytetarëve të tyre katolikë.

Sipas një shënimi në gazetën "Takvimi Vekajim" (shtypur në Stamboll me 25 shtator 1867) Molla Dauti, vazhdonte të ishte kryemësues dhe emri i tij ishte radhitur tashmë në listën e mësuesve më të mirë të prefekturave të ndryshme të shtetit e që kishin fituar tituj nderi. Nga korrespondenca e tij shkollë nxirret, që ai me 1870 ishte inspektor i arsimit fillor për prefekturën e Shkodrës, detyrë që e kishte filluar më 1869. Kësaj detyre ai iu përkushtua me ndërgjegje të lartë, me dëshirën e mirë, që drita e

arsimit të përhapëj edhe në skajet më të largëta të vendit. Këtë na e konfirmon edhe propozimi i paraqitur në ministrinë përkatëse për hapje shkollash të reja në nënprefekturat Peqin, Kavajë, Durrës, Krujë, Ulqin, me sensin e kompetentit e të njohësit të mirë të problemit, ndonëse bëhej fjalë për një hapësirë gati sa gjysma e Shqipërisë së sotme, propozimin e shoqëron edhe me sugjerime mbi rrugën e sigurimit të fondeve, si dhe të domosdoshmërisë që lokalet të strukturoheshin sipas kushteve bashkëkohore për institucionet arsimore. Në sajë të shkallës së lartë të kredibilitetit profesional, ministria ia aprovoi propozimin dhe atij i sugjeroi të përcaktonte numrin e lokaleve të reja, atyre të riparueshme dhe shpenzimet e nevojshme, madje i kërkohej edhe çfarë parashikonte për rrogat e mësuesve dhe mësuesve të përgatitjes së kuadrove të reja. Ishte fare normale, kur administrata e vilajetit ia njohu meritat me anë të një shkresë të datës 8/3/1874, sipas së cilës urdhëroheshin që të virtytshmit, Molla Dautit, t'i jepen të gjitha lehtësitë e nevojshme.

Në një telegram që i dërgon atij Ministria e Arsimit me 4 dhjetor 1879, i kumton se ishte caktuar të shkonte për të kontrolluar disa shkolla fillore në rrethet e Stambollit dhe për të raportuar rreth nevojave të reformimit të tyre. Ky ishte një shkas që ai të mbahej larg veprimtarisë politike të angazhimeve të tij në Lidhjen e Prizrenit.

Duke ia njohur përgatitjet dhe aftësitë, administrata osmane në fillim e caktoi të drejtonte një shkollë vajzash në Stamboll dhe pastaj inspektor shkolle në Anadoll. Larg familjes e mëmëdheut, pas vdekjes së të shoqes dhe hartimi të një peticioni të një përfaqësie nga Shkodra, ai u kthye në vendlindje, duke vazhduar karrierën në arsim. Nga një dokument merret vesh se në vitin 1888 figuronte drejtor arsimit. Në vitin 1892 ai paraqet dokumentet për të dalë në pension,

por kjo kërkesë iu realizua vetëm në vitin 1894.

Daut Boriçi si politikan dhe diplomat

Në botimet shqiptare me karakter historik është pranuar mendimi se Daut Boriçi e filloi veprimtarinë politike njëkohësisht me ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit, mirëpo studiuesi Hamdi Bushati sjell argumente se Dauti nisi të aktivizohej në problemet politike qysh në vitin 1869.

Me 15 qershor 1878, dy ditë pas hapjes së Kongresit të Berlinit u zhvillua një manifestim i fuqishëm në Pazar të Vjetër, në oborrin e bibliotekës, pranë Medresesë dhe në mes një entuziazmi mbarëpopullor u lexua peticioni dërguar Kongresit të Berlinit në shenjë proteste. Sigurisht, ndër nismëtarët e këtij telegrami ka qenë edhe Daut Boriçi, nënshkrimi i të cilit është ndër të parët e 380 firmëtarëve të këtij memorandumit, që iu dërgua Kongresit më 16 qershor jo vetëm në emër të Shkodrës, por edhe të viseve e qyteteve të Shqipërisë Veriore e të Mesme. Mes të tjerave aty theksohej: "...Kombi shqiptar, qoftë mysliman, qoftë katolik, krejt ndryshe për nga raca dhe nga feja nga ato të sllavëve, është i vendosur të mbrojë atdheun kundër çdo copëtimi tokësor." dhe më tej "...lutemi të mbronë tërësinë tonë kombëtare e tokësore e të na kurseni konfliktet shkatërrimtare që do të shpërthejnë..."[2]

Daut Boriçi ndonëse nëpunës i rangut të lartë në administratën lokale osmane, jo vetëm i bëri ballë çdo presioni, por edhe iu priu të tjerëve duke u vënë në shërbim të çështjes kombëtare. Me datën 11 korrik 1878 u krijua Dega e Shkodrës e Lidhjes së Prizrenit, e quajtur edhe Komiteti Ndërkrahinor, i përbërë prej 20 vetash me në krye Daut Boriçin. Dega e re, e porsakrijuar kaloi nga fjalët në vepër, nga solidarizimi politik me vendimet e Lidhjes, në organizimin e shpejtë të njësisë vullnetare të armatosura. Dega lajmëroi qendrën se ishte gati të dërgonte 6000

vullnetarë për ta shkëputur Tivarin dhe pastaj Podgoricën nga dora e malazezëve, por kjo nuk u realizua. Krijimi i kontigjentit të "xhandarëve të Degës" për të ruajtur rendin ia rriti asaj autoritetin dhe përgatiti atmosferën për veprime edhe më radikale. Ngjarjet u rrokullisen kundër dëshirave të shqiptarëve, sepse si Tivari, ashtu Podgorica, Zhabjaku, Shpuza kaluan nën sundimin malazes. Fluksit të madh të emigrantëve nga këto treva u desh t'i bënte ballë Shkodra dhe i takonte Komitetit të Lidhjes të organizonte punën, duke aktivizuar komisionet e saj. Pavarësisht se qytetit iu krijuan probleme të reja social-ekonomike, ato u përballuan në sajë të bujarisë e solidaritetit mbarëqytetar, si dhe përkushtimit të aktivistëve të Lidhjes, bashkëpunëtorëve të Daut Boriçit, Jusuf Tabakut, Jusuf Sokolit, Selim Çobës, vëllezërve Dragusha etj.

Ndërkaq Komiteti e kishte të qartë që duhej luftuar jo vetëm me gjuhën e armëve, por edhe me atë të diplomacisë, prandaj u vendos që me 18 maj 1879 t'u bëhej një promemorie konsujve të huaj, që gjendeshin në qytet. Si në të gjitha dokumentet e nxjerra nga Komiteti Ndërkrahinor, edhe këtë radhë Daut Boriçi nënshkruante i pari dhe patjetër ndërmjet atyre radhëve fekste edhe mendimi i pjekur prej intelektualit, gjykimi i tij i mprehtë prej diplomati dhe ndjenja e zjarrtë prej atdhetari.

Dy vjet pasi doli në pension, pikërisht me 2 nëntor 1896, Daut Boriçi ndërroi jetë dhe u varros në varrezat e xhamisë së Luguçesmes.

Daut Boriçi, gjuhëtar dhe autor i teksteve

Një profil i tretë i Daut Boriçit, jo më pak i rëndësishëm, është edhe ai i gjuhëtarit e i krijuesit të teksteve shkollore. Kontributi i tij në lëmin e arsimit nuk u reduktua vetëm në kuadrin e veprimtarisë legale në atë sektor. Ashtu siç thuhet në Historinë e Shqipërisë[3], "...kleriku patriot mysliman, Daut Boriçi, botoi

me 1869, në Stamboll një abetare të gjuhës shqipe, e cila duke përdorur alfabetin arab, përpiquej të fitonte për çështjen kombëtare shtresa e gjerë e popullatës myslimane, pa rënë në sy të censurës." Pikërisht Daut Boriçi botoi abetaren turqisht-shqip në themel të një alfabeti të hartuar prej tij me shkronja arabe.

Me sa dihet, informacionet e para mbi krijimtarinë e Daut Boriçit i kemi nga revista "Dituria" e L. Skendos (viti 1927 dhe 1928) përmes rubrikave "Bibliografia shqipe", "Letra nga këndonjësit", mbështetur në informacionet e dy mësuesve shkodranë Sh. Muka e H. Bushati.

Rreth botimeve të abetares, si dhe rreth veprave të tjera, Prof. Dr. Jup Kastrati ka dhënë një informacion më të gjerë në "Buletin për shkëmbimin e eksperiencës" viti 1954[4], duke e paraqitur të plotë në veprën e tij "Figura të ndritura të Rilindjes Kombëtare", ku ai shpjegon për botimin e abetares në vitin 1869 dhe disa ribotime të tjera në vitet 1869 dhe 1881, hartimin e një "Gramatike shqip", njohuri të përgjithshme mbi emrin, numrin, gjininë, etj. Vepra është e pakryer dhe dorëshkrim. Ai ka hartuar gjithashtu edhe fjalorin turqisht-shqip, dorëshkrimi i të cilit ruhet në Arkivin e Shtetit.

Përveç këtyre ai la dorëshkrim një autobiografi dhe dy ditarë, njëri i vitit 1884-1890, tjetri i vitit 1893-1895.

Krahas punimeve të autorëve të tjerë, kontributi gjuhësor i këtij personaliteti u trajtua edhe nga studiuesit Sh. Osmani, Nj. Kazazi, T. Osmani në simpoziumin shkencor me rastin e 100 vjetorit të vdekjes së Daut Boriçit (Shkodër, nëntor 1996).

[1] Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, "Në kujtim të brezave", Rozafat, 1997: 88.

[2] Po aty, fq. 94.

[3] "Historia e Shqipërisë", vëllimi i dytë, Tiranë, 1965: 107.

[4] Kastrati, Prof. Dr. Jup, "Buletini për shkëmbimin e eksperiencës", Shkodër, 1954: 7

NDIHENI TË URITUR

emocionalisht

Nëse ndiheni vazhdimisht të uritur, atëherë zgjidhjen kërkojeni jo te stomaku, por tek emocionet, ndienjat tuaja. Ndryshe nga uria fizike, uria emocionale shfaqet në dëshirën për të ngrënë vazhdimisht diçka, të ndiesh kënaqësi pas ngrënies, të ndihesh i penduar ose në faj për atë që bën.

Ka shumë teori të paraqitura nga specialistë të ndryshëm në lidhje me çrregullimin e urisë emocionale. Njëra nga këta është dhe teoria e largimit ose shmangies. Të largohesh nga ndienja e sigurisë, të largohesh nga dhimbja që të shkakton kjo ndjenjë, të largohesh nga përgjegjësia e zgjidhjes së problemit... Një nga nevojat themelore të njeriut është ndjesia e sigurisë. Prandaj në shumicën e rasteve zgjedhim të largohemi apo shmangim problemin, stresin apo ankthin që na krijon një situatë e caktuar. Kështu vepron edhe mendja jonë, sa here që përballemi me diçka që na streson ajo na dërgon sinjalin e largimit dhe të fokusimit tek ngrënia megjithëse trupi ynë mund të jetë i ngopur. Edhe të fjeturit shumë, të shikuarit shumë tv, të mos dëshirosh të qëndrosh vetëm është një lloj përpjekjeje për të shmangur problemin.

Në të vërtetë kjo dëshirë e vazhdueshme për të ngrënë na ka mbetur nga fëmijëria. Kur lindim, thithim gjirin e nënës jo vetëm kur jemi të uritur, ndonjëherë e kërkojmë për t'u qetësuar, ndonjëherë për t'u lidhur me nënën, kërkojmë ngrohtësinë, sigurinë e saj, të kuptojmë se nuk jemi vetëm, të na lehtësojë dhimbjen, frikën. Këto nevoja themelore të cilat kërkohen të plotësohen me anë të gojës nga ana e një fëmije i cili nuk është i zhvilluar mendërisht, me kalimin e kohës përdorin ushqimin si qetësues ose plotësues të mangësive. Fëmija mund të qetësohet me anë të thithjes së gjirit të nënës edhe kur është i ngopur, ndjen kënaqësi dhe qetësohet, por me kalimin e kohës fillojnë të zhvillohen dhe aftësitë njohëse. Ai krijon lidhjen me prindërit jo vetëm me anë të gojës, por edhe të syve, veshëve, trupit, mimikës. Ndienjat sa vijnë e bëhen më komplekse. fillojmë të kuptojmë se kemi edhe nevoja të tjera përveç urisë dhe kënaqësisë. Këto nevoja janë pikërisht dhe ato që nxjerrin në pah urinë

tonë emocionale, dhe këto janë ndienjat si: pranimi pa kushte, lavdërimi, aprovimi, mirëkuptimi, mbështetja etj. Kur këto nevoja nuk plotësohen në mënyrën e duhur, atëherë mund të kërkojmë zgjidhje të shkurtra si fokusimi tek ushqimi. Veçanërisht fokusimi drejt ushqimeve të pasura me sheqer dhe karbohidrate.

Në këtë mënyrë fillon dhe udhëtimi ynë i ushqimit emocional. Edhe në momentet që nuk jeni të uritur mbeteni vetëm me ndjenjat e fajit dhe pendimit. Nëse më vonë kemi edhe një shtim në peshë problemi dyfishohet. Në këtë rast, personi mendon se ka probleme me peshën dhe i drejtohet dietologut por kërkimi i një psikologu do ishte zgjidhja e duhur.

Si ekuilibrohet çrregullimi emocional?

Uria emocionale apo çrregullimi i ngrënies emocionale nuk kalon duke ngrënë apo duke lënë ushqimin. Kjo gjendje nuk ka lidhje me ushqimet. Të gjitha dietat e bëra, ushtrimet fizike nuk mund të kenë efekt pozitiv nëse nuk kuptohet arsyeja e vërtetë. Shumica e njerëzve mund të të nxisin duke thënë të ndalosh ushqimin, të përdorësh vullnetin, të fillosh dietën, mirëpo prioriteti këtu është zbulimi i ndienjave.

Për të mbajtur nën kontroll situatën, pikësëpari duhet të njohim mirë ndienjat tona, të analizojmë efektin e fenomeneve që prekin jetën tonë, të ndajmë ndienjat nga ushqimi dhe të fokusohemi tek nevojat tona psikologjike. Rrënjët e këtij problemi zgjaten deri në fëmijëri apo adoleshencë. Përjetimet e vështira të asaj kohe, qëndrimet e gabuara të prindërve mund të na shtojnë drejt ushqimeve për të qetësuar veten dhe për t'u ndjerë më mirë. Nëse fillojmë ta ndiejmë stomakun kur zemërohem apo stresohemi ndaj diçkaje, atëherë mund të themi se vuajmë nga uria emocionale.

Ndjekja e një psikoterapie klasike ku fokusimi është tek çrregullimi emocional, ku mund të përcaktohen mirë se cilat janë ndienjat ndaj të cilave reagojmë me anë të ushqimit, shqetësimet, ankthet e të kaluarës. Me anë të aftësive të reja të rifituara mund të ndalojmë ngrënien e tepërt dhe të bëjmë një organizim fizik e emocional të vetes.





Njalti

ANTIBIOTIKU NATYRAL

***"Dhe Zoti yt e frymëzoi bletën: - Ndërto shtëpi nëpër male, nëpër pemë dhe nëpër kulmet që njerëzit ndërtojnë. Pastaj ha nga të gjitha llojet e frutave dhe ndiq rrugët e nënshtruara prej Zotit tënd. Nga barqet e tyre (femrat) del një lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka shërim për njerëzit. Këto janë shenja për popullin që mendon thellë."
(Kur'an 16:68-69)***

Në një hadith të transmetuar nga Ibn Abbasi, Profeti a.s. ka thënë: - Shërimi gjendet në tre gjëra, hedhjen e kupave, pirjen e mjaltit dhe vulosjen me hekur të nxehtë (kauterizimin), por unë ua kam ndaluar Umetit tim hekurin e nxehtë.

Ajo çfarë nënkuptohet me frymëzim të bletës është udhëzimi që Allahu i ka dhënë asaj. Ajo është e udhëzuar të ndërtojë shtëpi në male, në pemë dhe në koshere të ndërtuara nga njeriu. Kosherja e bletës është një strukturë e fortë e ndërtuar nga dhomëza të vogla gjashtëkëndore të ngjitura me njëra-tjetrën duke mos lënë asnjë hapësirë në mes. Më pas Allahu e urdhëroi bletën të shëtisë dhe të ushqehet nga të gjitha lulet dhe frutat që Zoti ka krijuar për të. Pastaj ajo kthehet në kosheren e saj pa u ngatërruar aspak dhe shkon drejt te dhomëza e saj ku gjenden vezët dhe mjalti që duhet ruajtur. Ajo përgatit dyllin me anë të krahëve dhe e nxjerr nektarin nga barku në hoje për të prodhuar mjaltin dhe të nesërmen del përsëri për kullotë.

Mjalti është përdorur nga njeriu prej shekujsh. Ai është i pëlqyer si nga fëmijët edhe nga të rriturit. Mjalti është nga ato ushqime të lëngshme, i cili mund të përdoret edhe si kozmetik ose antimikrobik. Nëse shikon nëpër dyqane kozmetike do të gjesh prodhime me bazë mjalti që përdoren si pomada natyrale për të mbajtur lëkurën të shëndetshme. E veçanta për mjaltin është se megjithëse është një ushqim i ëmbël, ai me kalimin e kohës nuk prishet e as nuk tharohet. Nëse e mban në temperaturë dhomë ai mund të rezistojë pa e gjetur asgjë. Për të dhënë një provë konkrete mbi këtë mund të përmendim si shembull enët me mjaltë të gjetura në varret e faraonëve. Në njërën nga këto enë të gjetura në piramidat e Egjiptit dhe që mendohet të jetë rreth 3000 vjeçare, kishte një sasi mjalti i cili mund të konsumohej edhe sot e kësaj dite.

Rëndësia historike dhe përdorimet qindrvjeçare të mjaltit së bashku me veçoritë e tij, kanë tërhequr vëmendjen e shumë shkencëtarëve gjatë shekujve.

Ata kanë studiuar veçoritë kimike dhe mekanizmat biokimike pas të cilave qëndrojnë vetitë e tij kuruese. Kërkimet e fundit kanë treguar se mjalti ka veti të mira antimikrobike dhe antibiotike.

Mjalti që del nga barku i bletëve është me ngjyra të ndryshme si i bardhë, i verdhë i kuq ose i një ngjyre tjetër në varësi të lules dhe në të ka shërim për njeriun. Kjo do të thotë se disa sëmundje të njeriut mund të shërohen me mjaltë. Disa dijetarë duke u bazuar në ajetin kuranor kanë thënë se mjalti është i dobishëm për çdo sëmundje. Disa të tjerë kanë thënë se është vetëm për disa sëmundje si gripi apo "e ftohura".

Në një hadith Profetik thuhet se një burrë erdhi te Profeti a.s. dhe i tha: - Vëllai im është sëmurë me diarre. Ai u përgjigj: - Jepini të pijë mjaltë. Burri shkoi, i dha vëllait mjaltë dhe u kthye duke thënë: - O i Dërguari i Allahut, unë i dhashë mjaltë, por ai u bë më keq. Profeti a.s. i tha: - Jepi përsëri të pijë mjaltë. Burri shkoi përsëri dhe u kthye duke thënë: - O i Dërguari i Allahut, unë i dhashë mjaltë, por ai u bë më keq. Profeti a.s. tha: - Allahu thotë vetëm të drejtën, ndërsa stomaku i vëllait tënd po gënjen, shko dhe jepi përsëri mjaltë. Kështu burri shkoi për herën e tretë, i dha përsëri mjaltë dhe vëllai u shërua.

Në një hadith tjetër transmetohet nga Aisheja r.a. se Profeti a.s. i pëlqente gjërat e ëmbla dhe mjaltin.

Midis faktorëve që i japin atij këto veçori të dobishme për shëndetin mund të përmendim aciditetin e lartë (pH 3.5-4), përmbajtjen e ulët të ujit (më pak se 17% me sasi të lartë sheqeri), prania e peroksidit të hidrogjenit, prania e disa përbërjeve organike si fenolet dhe metilglioksalet të cilat variojnë nga lloji i lules prej të cilës është prodhuar mjalti.

Kërkime të tjera nga Susan M. Meschwitz të Universitetit Salve Regina tregojnë që mjalti pengon komunikimin kimik të baktereve me njëri-tjetrin duke mundësuar kështu uljen e virulencës, ngjithshmërisë dhe rezistencës antibiotike.

Për të kuptuar se si vepron secila nga këto veçori të mjaltit, në fillim duhet të kuptojmë se si prodhohet ai nga bleta dhe cila është përmbajtja e tij.

Bletët mbledhin nektarin e luleve, i cili është një përzjerje e disa sheqernave, proteinave dhe lëndëve të tjera organike në një solucion me bazë uji. Nga më shumë se 100 përbërësit e mjaltit, disa nga këto janë lëndë organike volatile, siç janë fenolet të cilët i japin aromën mjaltit. Shumica e llojeve të mjaltit përmbajnë të njëjtin lloj fenoli, por në përqindje të ndryshme. Përderisa përbërja e nektarit që mbledhin bletët varet nga lloji i kullotës së lules, atëherë do të kemi shumë lloje mjalti në varësi të lules. Gjenden më shumë se 300 lloje të ndryshëm mjalti në Amerikë dhe më shumë se 3000 lloje në të gjithë botën. Sidoqoftë, përbërësit më të shpeshtë që dominojnë çdo lloj mjalti janë glukozja dhe fruktoza që gjenden në nektarin e të gjitha luleve.

Procesi nga mbledhja e nektarit deri te prodhimi final i mjaltit varet nga puna e palodhshme e bletëve. Ai fillon menjëherë në stomakun e bletëve punëtore sapo ato thithin nektarin nga lulet. Aty sakaroza, që është sheqeri i tavolinës, ndahet nga enzimata tretëse në dy përbërësit e tij që janë glukozja dhe fruktoza. Kjo rrit viskozitetin e nektarit ndërsa procesi i ndarjes vazhdon më tej. Bletët punëtore, sapo arrijnë në zgjuar, e nxjerrin nektarin nga stomaku së bashku me pështymën e tyre. Këtu nektari merret nga bletë të tjera të cilat vazhdojnë procesin me anë të enzimave specifike që i japin formën përfundimtare mjaltit së bashku me vetitë e tij mjekësore.

Ndërkohë që shpërbërja e sakarozës ka arritur nivelin e kërkuar, nektari i përpunuar vendoset në hoje për të filluar fazën pasardhëse që është ulja e përmbajtjes së ujit të nektarit. Kjo ndikon në formimin e aftësive kuruese të mjaltit. Nektari në formën origjinale kur është mbledhur nga bleta nëpër lule përmban rreth 70% ujë dhe pas përpunimit reduktohet në 17% në mjaltin përfundimtar. Ky proces i jep atij konsistencën e trashë dhe viskoze. Bletët e realizojnë këtë tharje të nektarit duke i rrahur flatrat e tyre me një shpejtësi marramendëse (rreth 200 herë/sekondë ose 12000 herë/minutë) duke qëndruar mbi hojen gjashtëkëndore të zgjoit. Ky veprim kyç jep si rezultat avullimin e ujit nga nektari dhe mund të zgjasë deri në 3 ditë.

Reduktimi i përmbajtjes së ujit është një hap tepër i rëndësishëm në marrjen e karakteristikave të veçanta të mjaltit. Kjo sjell parandalimin e rritjes së baktereve apo myqeve duke e bërë atë rezistent ndaj prishjes. Aktiviteti uhor matet me një shkallë nga 0 në 1 dhe aktiviteti uhor i mjaltit është rreth 0.6 të kësaj shkalë.

Si për çudi, myku dhe bakteret kërkojnë një aktivitet uhor rreth 0.75 për t'u shtuar dhe për të formuar kolonitë e tyre. Të njëjtat efekte antibakteriale mjalti mund t'i shfaqë edhe kur aplikohet direkt në një plagë të hapur duke parandaluar rritjen bakteriale mbi dhe përreth plagës.

Siç e përmendëm më lart, një nga faktorët që i japin mjaltit vetitë antibakteriale është edhe aciditeti i lartë i tij. Aciditeti i mjaltit varion midis vlerave të pH 3.5 dhe 4, gjë e cila e bën atë më acid se uthulla e mollës (pH rreth 4.5). Ky aciditet i mjaltit realizohet nga disa përbërje organike acide dhe varet nga lloji i lules së kullotës së bletës. Ndër këto lëndë mund të përmendim acidin formik, acidin citrik, acidin butirik, fenolet dhe acidin glukonik. Këto prodhohen nga veprimi i disa enzimave të pështymës së bletës mbi glukozën e mjaltit. Bakteret dhe myqet preferojnë një ambient neutral për të mbijetuar kështu që aciditeti i lartë së bashku me përmbajtjen e ulët të ujit përforcojnë efektet e tij antibiotike, duke siguruar një mjedis të vështirë për rritjen bakterore.

Peroksidi i hidrogjenit është një solucion i njohur për përdorimin e tij si pastrues plagësh dhe për veprimin antibakterial. Por shumica e njerëzve nuk e dinë se mjalti përmban peroksid hidrogjeni, i cili prodhohet si produkt anësor gjatë prodhimit të acidit glukonik nga veprimi enzimatik i glukozë oksidazës mbi glukozën.

Sipas kërkimeve dhe studimeve intensive mbi vetitë mjekësore dhe kuruese të mjaltit, ka rezultuar se të gjitha lëndët e përmendura më lart ndikojnë në pengimin e shumimit bakterial dhe atij mykotik. Nuk përjashtohet mundësia që në të ardhmen mund të zbulohen veti të reja të mjaltit që nuk njihen sot. Të gjithë këto përbërës varen nga lulja në të cilën bleta ka marrë nektarin sepse kjo i jep aromën, shijen dhe pamjen karakteristike çdo lloji të mjaltit. Meqë një produkt natyral si mjalti ka kaq dobi për shëndetin e njeriut, mund të themi se ai është një mrekulli nga Allahu për njeriun, i cili kërkon një vëmendje të madhe si nga mjekët edhe nga njerëzit e thjeshtë. Sidoqoftë, njerëz keqdashës të cilët mendojnë vetëm fitimin e të ardhurave nga mjalti kanë ndërhyrë në prodhimin e tij duke ia prishur vetitë e tij kuruese, por kjo temë është jashtë diskutimit tonë.

Pjesa e ajetit kuranor që thotë "ka shenja për njerëzit që mendojnë", ka kuptimin se Allahu ka frymëzuar një insekt të vogël të udhëtojë nëpër fusha të gjera dhe male të larta, të hajë nga çdo lule dhe frut dhe prej këtu të bëjë mjaltë dhe dyllë të cilët janë nga ushqimet më të mira për shëndetin e njeriut. Ai që mendon sadopak do ta kuptojë se kjo mirësi nuk është nga bleta, por nga Krijuesi i bletës që e ka udhëzuar atë. Me të vërtetë Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithëdituri.

Përktheu: Erion Sukaj



Ku është Ai?

E paqëndrueshme... Si çdo ditë tjetër. Ashtu rezultoi të ishte edhe e sotmja. Paqëndrueshmëria e vazhdueshme e kohës, zgjonte brenda çdo njeriu ndoshta një melankoli tashmë të pranishme, por akoma të paafte për ta bërë veten të dukshme. Një melankoli që përshtatet më së miri me përkufizimin e një vullkani në dukje jo aktiv, por që i mjafton edhe lëkundja më e vogël e një pllake tektonike që të shpërthejë dhe me vrullin e tij të etur për të vërshuar, të përpijë çdo gjë.

Dielli në ato ditë pranvere ishte gënjeshtari më i madh i kohës. Ndoshta edhe lojtari më profesionist për të të mashtruar për një çast. Si një fëmijë i turpshëm, ai e fsheh veten e vet pas reve imcake, duke treguar në një mënyrë të fshehur që pasuesi i këtij veprimi mund të jetë edhe shiu.

Në një moment të tillë, syri i njeriut qenka në gjendje dhe plotësisht i aftë të dallojë "të padukshmen".

Por sot jo! Çudi... Nuk po e shoh gjekundi. Sytë e mi tashmë të vetëdijshëm për atë që duan të gjejnë, lëvizin drejt çdo cepi, drejt çdo stacioni, drejt çdo skute jo dhe aq të rëndësishme, shpesh të rëndomtë. Nuk është! Ku të jetë vallë? Ku të jetë ajo fytyrë që më fal paqe? Ajo fytyrë engjëlllore që më sheh në sy dhe më bën të ndihem fajtorë pa faj? Ku të jetë ai zë aq i ngrohtë dhe i përvuajtur që tingëllon çdo mëngjes në veshët e mi?

Ku të jetë vallë? Në çfarë drejtimi ka ikur sot?

Dielli del përsëri. Duket sikur edhe ai është duke kërkuar "pronarin" e shikimeve të mia në këtë ditë. Në momentin që ai largohet, e kuptoj se nuk e ka gjetur...

Më mungon zëri i tij. Zëri, i cili paska bezdisur shumë të tjerë më mungon. Më mungon ajo pyetja karakteristike e tij që më bën gjithmonë të mendohem dhe që më lë pafjalë, në pamundësi për t'i kthyer një përgjigje.

E doja edhe sot atë pyetje, ndoshta mund edhe t'i ktheja përgjigje. Isha përgatitur në mënyrë shpirtërore dhe materiale për t'i kthyer një përgjigje që mund ta lumturonte, edhe pse për pak çaste.

Por ai nuk po vjen. Nuk po vjen të më pyesë në mënyrën që vetëm ai di ta bëjë, pa më bezdisur asnjë ditë te vetme.

Çfarë ka kaq shumë të veçantë prania e tij, zëri i tij? Është i panjohuri që ngroh zemrën time dhe i jep qetësinë dhe ndjesinë e paqes, të një familjeje.

Ku janë ato pak fjalë? Ku është ai zë? Mos ndoshta ngela shumë vonë? Ndoshta përgjigjia ime duhet të ishte kthyer më herët, ndoshta në kohë?

Ku ta gjej... Jam gati të përballem me të! T'i them vetëm diçka. Ta shoh të buzëqeshë me atë fytyrën engjëlllore që mesa duket paska zënë vend në zemrën time! ...

Pronari i përqafimeve të veçanta, të ngrohta, i atyre syve plot shkëlqim kur dikush i kthen një përgjigje pozitive dhe e bën të ndihet më pak i mjerë.

Pronari i syve që derdhin lot, jo nga vuajtja, por nga zemrat e zbutura që tregojnë mëshirë. Dhe në atë përlotje e sipër ai hidhet në përqafim, në krahët e një djaloshi që pret autobusin në stacion.

Ai djalosh e lumturoi me atë përgjigje që edhe unë doja ta kisha mundësinë sot t'ia ktheja. Por... Sot nuk qenka dita ime. Paskam ngelur shumë vonë.

Vonë për të thënë dy tri fjalë që ngrohin zemrën dhe dy tri qindarka që lumturojnë atë engjell që çdo mëngjes duke thënë "a keni nevojë për kartopeceta?" "largohej, duke mos të bezdisur më tepër.

Ai njeri aq i vuajtur, i rraskapitur, ishte në gjendje të buzëqeshte dhe t'i bënte njerëzit të lumtur me fjalët dhe lutjet e tij, me ato përqafimet e tij prej një prindi të dhembshur. I lodhur nga jeta? Edhe ndoshta, por i kënaqur me fatin e tij. I kënaqur me caktimin e Krijuesit. Falenderues për gjendjen e tij. I aftë për të kaluar provën, testimin.

Po unë? Ai ndoshta ishte sprovë ime për aq pak kohë. A e kalova dot? A do kem mundësi ta ndreq atë që bëra? Atë që nuk e bëra dot? A do kem mundësi të jap një lëmoshë në duart e tij, të shoh buzëqeshjen, lumturinë e tij? Atë lumturi që ndoshta më bën të fitoj edhe kënaqësinë e Allahut?

E mira gjendet me shumicë në detaje, në vockërrina. E mira vjen e servirur drejt teje. Ji mirënjohës dhe pranoje atë.

Pa qenë shumë vonë.



Standarte bashkëkohore sipas rregullave qiellore!

PAMIJE PANORAMIKE
USHQIM HALLAL
DHOMA ÇIFT, TRESHE & SUITA


BLUE ORCHIDEA
HOTEL

 Uji i Ftohtë, Vlorë

 www.blueorchidea.com

 069 565 3323